



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1124/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave afër Qendrës së Votimit, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.1124/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje i **SHQIPTOHET** gjobë në vlerë prej 1,300.00€ (një mijë e treqind euro,), për shkak të vendosjes së posterave afër Qendrës së Votimit, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 14.11.2021.

**II. DETYROHET** Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

PZAP-i me datën 14.11.2021, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se me datë 14 nëntor 2021, aktivistet e LDK-së, rreth orës 09:30 të mëngjesit kanë vërejtur se subjekti politik LVV, ka shkelur nenin 36 paragrafi . pika b), të LZP-së, pasi që ka vendosur material zgjedhor në më pak se 100m afër qendrës së

votimit, në rastin konkret 10m, në qendrën e votimit “Elena Gjika” Prishtinë. Gjithashtu kjo ankesë ushtrohet ndaj subjektit politik LVV, ngase më datën 13 nëntor 2021, aktivistët e LDK-së, rreth orës 16:30, kanë vërejtur se subjekti politik LVV, ka shkelur nenin e lartcekur, pasi që ka vendosur material zgjedhor në më pak se 100m, afër qendrës së votimit në rastin konkret në distancë 30m, në Qendrën e Votimit “Ahmet Gashi” Prishtinë. Andaj duke u mbështetur në të cekurat më lartë kërkojmë nga PZAP, që masa e sanksionit të vendosët në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Si dëshmi ka bashkangjitur Foto –dëshmitë të përmbledhura në CD.

PZAP, me datë 14.11.2021, i ka dërguar subjektit politik kërkesë për përgjigje, me afat kohorë deri me datë 15.11.2021, në ora 09:00.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën ka theksuar se të gjitha materialet zgjedhore janë shpërndarë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pra në asnjë mënyrë nuk janë të vërteta pretendimet e ankuesit se është shpërndarë material zgjedhor gjatë heshtjes zgjedhore dhe në afërsi të qendrave të votimit. Pra në asnjë mënyrë nuk dëshmohet pretendimi i ankuesit me provat e paraqitura. Po ashtu thekson se pretendimet e ngritura për distancën me qendrën e votimit, nuk janë pretendime të qëndrueshme, pra si të tilla janë të rrëzueshme. Pasi që distanca nga qendrat e votimit është më tepër se 100m, respektivisht kjo distancë nuk bie ndesh me dispozitat e LPZ-së. Me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht videot e ofruara si provë të bashkangjitura në ankesë vërtetohet fakti se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka vendosur material zgjedhor në më pak se 100m afër Qendrës së Votimit, “Elena Gjika” Prishtinë. Gjithashtu nga provat e ofruara në ankesë vërtetohet fakti se po i njëjti subjekt, ka vendosur material zgjedhor në më pak se 100m, afër Qendrës së Votimit “Ahmet Gashi” Prishtinë.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pretendimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117

par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nga të njëjtat vërtetohet faktin e pretenduar si në parashtrimet e ankesës se posteri i kandidatit për Kryetarit të Prishtinës Arben Vitia, ka qenë i vendosur afër Qendrave të Votimit, saktësisht afër Qendrës së Votimit, “Elena Gjika” Prishtinë dhe Qendrës së Votimit “Ahmet Gashi” Prishtinë. Me këtë veprim subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore, duke vendosur poster të kandidatit të tyre për kryetar të Komunës së Prishtinës afër Qendrës së Votimit.

Andaj Paneli nga videot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posteri i kandidatit për Kryetar të Komunës së Prishtinës Arben Vitia është vendosur afër Qendrave të votimit të cekura më lartë gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;”*.

Paneli, gjithashtu duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, është përgjegjëse për veprimet e tij, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton se: *“veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lartcekura, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, shumë e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet

klime e qete dhe e pershtatshme per votim te lire dhe te pa ndikuar si bazament i nje procesi demokratik zgjedhor.

Nese subjekti te cilit i eshte shqiptuar denimi nuk e paguan te njejtin brenda afatit te percaktuar ne dispozitiv te tij, atehere ne pajtim me nenin 120.2 te LZP-se, subjektit do ti shqiptohet denim shtese. Ky paralajmerim per denim shtese eshte percaktuar me nenin 120.2 te LZP, i cili percakton: " 120.2 Deshtimi per te paguar denimin apo per t'ju bindur nje urdhërese te PZAP-it brenda periudhes kohore te saktësuar ne vendimin e PZAP-it, eshte nje shkelje tjetër e ketij ligji qe mund te sanksionohet me denim shtese nga PZAP-i.", ashtu sic eshte vendosur ne pikën II te dispozitivit te ketij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të ketij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**

Anr. 1124/2021 më datën 15.11.2021



***Këshilla Juridike: Kundër ketij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***